

VENDIM

Nr. 2, Datë 26.01.2012

PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË RREGULLOREN E ZGJEDHJEVE PËR AUZTORITETET DHE ORAGNET DREJTUESE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Senati i Universitetit të Arteve në mbledhjen e datës 26.01.2012, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN SE

Me Vendimin nr. 1 datë 17.01.2012 Senati Akademik ka miratuar Rregulloren e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin e Arteve. Në këtë dokument janë parashikuar ndër të tjera edhe rregulla lidhur me ngritjen e Komisioneve zgjedhore. Duke qenë se gjatë procesit zgjedhor mund të paraqiten raste të shkeljes së detyrimeve apo mosparaqitje të anëtarëve të këtyre komisioneve, Senati Akademik e sheh me vend parashikimin e rregullave për shkarkimin dhe zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore. Për sa më sipër Senati Akademik,

VENDOSI

1. Në Rregulloren e Zgjedhjeve bëhen këto shtesa e ndryshime:
 - a. Pas pikës 5.11 shtohet pikat 5.12 dhe 5.13 me përmbajtje si vijon:

"5.12. Në rastet kur një anëtar i KZF nuk paraqitet në detyrë apo kryen veprime të cilat bien ndesh me legjislacionin në fuqi apo me Rregulloren e Zgjedhjeve, atëherë KQZI ka tagrin për të vendosur shkarkimin e anëtarit të KZF dhe emërimin e një anëtari tjetër zëvendësues. Në këtë rast KQZI mund të marrë në konsideratë propozimet e bëra nga subjektet e interesuara.

5.13. Në rastet kur një anëtar i KQZI apo KA nuk paraqitet në detyrë apo kryen veprime të cilat bien ndesh me legjislacionin në fuqi apo me Rregulloren e Zgjedhjeve, atëherë Senati Akademik ka tagrin për të vendosur shkarkimin e anëtarit të KQZI apo KA dhe emërimin e një anëtari tjetër zëvendësues. Në këtë rast Senati Akademik mund të marrë në konsideratë propozimet e bëra nga subjektet e interesuara."
2. Në pikën 7.9 fjalët "personeli akademik" zëvendësohen me fjalët "personeli joakademik".
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet publikisht.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE